



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

Nr. 06 Prot.

Tiranë më 04. 03. 2021


**Lënda:** Dërgohen sqarime për formularët e aplikimit për vetëkandidim në komisionet e zgjedhjeve në njësitë përbërëse të UT-së

**Drejtuar:** **GJITHË FAKULTETEVE  
INSTITUTIT TË FIZIKËS BËRTHAMORE TË ZBATUAR  
FILIALIT TË UT-së, SARANDË**

Në zbatim të nenit 7 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës, në datën 02.03.2021, ju ka dërguar Vendimin nr. 2, datë 01.03.2021 “Për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në njësitë përbërëse të UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për anëtarë të tyre” dhe Vendimin nr. 3, datë 01.03.2021 “Për përcaktimin e numrit të anëtarëve të Komisioneve të Zgjedhjeve, në njësitë përbërëse të UT-së” .

Në kushtet kur ka pasur kërkesa për sqarim në lidhje me dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët e interesuar bashkëlidhur formularit të aplikimit, sqarojmë si më poshtë vijon:

1. Kandidatët e interesuar nga personeli akademik, duhet të paraqesin këtë dokumentacion:
  - Vërtetim nga struktura e Burimeve Njerëzore të njësisë kryesore, ku të specifikohet edhe njësia bazë ku bën pjesë;
  - Fotokopje të dokumentit të identifikimit.
2. Kandidatët e interesuar nga studentët, duhet të paraqesin këtë dokumentacion:
  - Vërtetim nga njësia ku studenti ndjek programin e studimeve, shoqëruar me listën e notave të përditësuar;
  - Fotokopje të dokumentit të identifikimit.
3. Kandidatët e interesuar për sekretar, duhet të paraqesin këtë dokumentacion:



- Certifikim nga struktura e Burimeve Njerëzore të njësisë kryesore;
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit.

Lutemi të ky sqarim, të publikohet në të publikohen në mjediset e njësive përbërëse, të IFBZ-së dhe në faqet përkatëse zyrtare të tyre dhe UT-së.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

**KRYETARI**

**Dr. Edvin Lame**

